




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 548/11 prot.

Shkodër, më 03.09.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 26, datë 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 24, të ligjit Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH" i përditësuar, të VKM Nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i përditësuar, të Vendimit të KB "Mbi miratimin e kriterëve specifike për fondin 6% të ndihmës ekonomike për vitin respektiv", shqyrtoi vendimin **Nr. 26, datë 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz** "Për dhënien e ndihmës ekonomike si minimum jetik duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike për muajin korrik 2025".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni për trajtimin e 27 familjeve në shumën 106.458 lekë, duke përdorur deri në 6% të fondit total të ndihmës ekonomike prej 1.803.210 lekë për muajin Korrik 2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

